

20231292388

**LIGJ I GARANCISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NDAJ
DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES FINANCIARE TË HUAS SË BANKËS
ZHVILLIMORE TË MAQEDONISË SË VERIUT SHA SHKUP PËR NDËRMARRJET E
VOGLA DHE TË MESME DHE NDËRMARRJET ME KAPITALIZIM TË MESËM TË
TREGUT DHE TRANZICIONIN E GJELBËR, QË DO TË LIDHET MES BANKËS
EUROPIANE TË INVESTIMEVE DHE BANKËS ZHVILLIMORE TË
MAQEDONISË SË VERIUT SHA SHKUP**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton plotësimin e detyrimeve të Marrëveshjes financiare të huas së Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjet me kapitalizim të mesëm të tregut dhe tranzicionin e gjelbër, në vlerë prej 100.000.000 euro, që do të lidhet ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve dhe Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, nëse Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup nuk i përmbush dhe nuk i kryen detyrimet brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen financiare.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen financiare të huas së Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjet me kapitalizim të mesëm të tregut si dhe tranzicionin e gjelbër, që do të lidhet ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve dhe Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup.

Neni 3

Të gjitha detyrimet të cilat rezultojnë nga Marrëveshja financiare e huas së Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjet me kapitalizim të mesëm të tregut si dhe tranzicionin e gjelbër do t'i servisojë Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup.

Neni 4

Huaja sipas nenit 1 të këtij neni do të tërhiqet më së shumti në 20 transhe. Vlera minimale e transhesë është 5.000.000 euro.

Për çdo tërheqje të vlerës nga huaja në transhe, Banka Europiane e Investimeve do të lëshojë Njoftim lidhur me tërheqjen në fjalë, ku do të përcaktohen kushtet përfundimtare financiare të transhesë, duke përfshirë: vlerën e transhesë, datën e pagesës, normën e interesit, afatin e shlyerjes dhe kushtet e tjera për tërheqjen e mjeteve.

Afati i shlyerjes së secilës transhe të huas, përveç të transhesë së mjeteve qarkulluese, mund të jetë nga katër vjet në 12 vjet nga data e tërheqjes së transhesë, duke përfshirë grejs periudhën që mund të jetë nga 30 ditë deri në katër vjet nga data e tërheqjes së transhesë. Afati i shlyerjes së huas do të përcaktohet për çdo transhe veçmas në njoftimin për tërheqjen e transhesë. Transheja gjithashtu mund të shlyhet një herë në ditën që është nga tre deri në tetë vjet nga dita e tërheqjes së transhesë.

Afati për shlyerjen e transhesë së mjeteve qarkulluese mund të jetë nga katër vjet deri në pesë vjet nga data e tërheqjes së transhesë, duke përfshirë grejs periudhën që mund të jetë nga 30 ditë deri në një vit nga data e tërheqjes së transhesë. Afati i shlyerjes së huas do të përcaktohet për secilën transhe veçmas në Njoftimin për tërheqjen e transhesë. Transheja për mjetet qarkulluese mund të shlyhet një herë në ditën që është tre vjet nga dita e tërheqjes së transhesë.

Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup do t'i paguajë Bankës Europiane të Investimeve provizion të njëhershëm në vlerë prej 50.000 eurove në afat prej 30 ditësh nga dita e lidhjes së Marrëveshjes financiare për hua nga Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup për ndërmarrjet e vogla dhe mesme, ndërmarrjet e mesme të kapitalizuara të tregut dhe për tranzicionin e gjelbër.

Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup do t'i paguajë Bankës Europiane të Investimeve, provizion për mjetet e patërhequra nga huaja në vlerë prej 0.1% të huas në nivel vjetor.

Provizioni për mjetet e patërhequra nga huaja do të fillojë të llogaritet pas 24 muajve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes financiare të huas së Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjet me kapitalizim të mesëm të tregut dhe tranzicionin e gjelbër.

Neni 5

Norma e interesit do të përcaktohet për çdo transhe të huas veçmas në njoftimin për tërheqjen e transhesë.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella, që rezultojnë nga Marrëveshja financiare e huas së Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjet me kapitalizim të mesëm të tregut si dhe tranzicionin e gjelbër dhe Marrëveshja e garancisë, Ministria e Financave dhe Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.